



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura III**  
**Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri**  
**Mbledhja nr. 07**  
**Data 08. 05. 2008**

**P R O C E S V E R B A L**

Mbledhjen e kryesoi:  
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:  
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanović Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu,  
Agim Veliu, Gani Geci, Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi.

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Ibush Mujaj, Biljana Petrović, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-10, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, me këtë rend dite:

**R e n d i i d i t ë s :**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.04.2008
3. Miratimi i Raportit nga Dëgjimi me Institucionet e Sigurisë të datës 21.04.2008
4. Njoftim për Dëgjimin Publik për Projektligjin për Sigurinë Private
5. Shqyrtimi i vërejtjeve për Ligjin nr. 02/L-117 për Numrin personal dhe atyre për Ligjin nr. 02/L-119 për Letërnjoftimin nga zyra ligjore e UNMIK-ut
6. Të ndryshme

**Pika e parë:** Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

**Pika e dytë:** Procesverbali i mbledhjes së datës 14.04.2008, u miratua pa vërejtje.

**Pika e tretë:** Raporti nga dëgjimi me Institucionet e sigurisë të datës 21.04.2008 u miratua pa vërejtje.

**Pika e katërt:** Në lidhje me këtë pikë, Emrush Xhemajli si kryesues i Projektligjit për sigurinë private, i njoftoi të pranishmit se për këtë projektligj do të mbahet një dëgjim publik me kompanitë private të sigurimeve që funksionojnë në Kosovë. Ai gjithashtu kërkoj që në këtë dëgjim, të marrin pjesë të gjithë anëtarët e komisionit.

**Pika e pestë:** Kishte të bënte me shqyrtimin e vërejtjeve për Ligjin nr. 02/L-117 për Numrin personal dhe atyre për Ligjin nr. 02/L-119 për Letërnjoftimin nga zyra ligjore e UNMIK-ut, dhe për tu marr me shqyrtimin e këtyre vërejtjeve, Kryetari i komisionit propozoi që të caktohet një grup punues i përbërë nga: Naim Maloku, Agim Veliu, Bojan Stojanivić dhe Shkumbin Demaliaj.

Në lidhje me këtë pikë, Bojan Stojanivić kërkoj që të dhënat në letërnjoftim, në gjuhën serbe të shkruhen me shkronja qirilic dhe jo me latine.

**Pika e gjashtë:** në këtë pikë u diskutua kryesisht rreth vizitës që do ta bëj komisioni në Gjenevë. Kryetari i komisionit Rustem Mustafa kërkoj nga anëtarët e komisionit që deri të premtën ta konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre për këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Kryetari i Komisionit  
Rustem Mustafa